



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E APELIT VLORE

Nr.780 akti  
Date 10.6.2013

Nr.171 vendimi  
Date 11.3.2015

V E N D I M  
NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Apelit Vlore, e perbere prej :

- |        |          |            |
|--------|----------|------------|
| Sokol  | Ngresi   | - Kryesues |
| Vasil  | Hanxhari | - Anetar   |
| Petrit | Aliaj    | - Anetar   |

asistuar prej sekretares gjyqesore Jonida Mustafaj, ne date 11.3.2015, ne seance gjyqesore me dyer te hapura, me pjesemarrjen e Komitetit te Prokurorise prane Gjykates se Apelit Vlore Kleantih Zekaj, i cili ne shqyrtim ne shkalle te dyte ceshtjen penale me nr.780 akti qe i per...

I PANDEHUR :

**POLIMER BEJO**, gjykuar ne mungese me shprehjen e tij, i mbrojtur nga avokat Edmond Demaj;

**STEFAN BILLA**, gjykuar ne mungese me pelqimin e tij, i mbrojtur nga avokat Edmond Demaj, i caktuar kryesisht nga gjykata e apelit;

AKUZUAR :

-Falsifikimi i dokumentave me shume se nje here, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

Gjykata e Shkalles se Pare Vlore, me vendimin nr.184 date 7.5.2013, ka vendosur :

- Pushimin e ceshtjes penale me numer rregjistri 865(156) date 26.12.2012 ne ngarkim te te pandehurve Polimer Beja dhe Stefan Billa te akuzuar per

kryerjen e vepres penale "Fallsifikimi i dokumentave" me shume se nje here parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

Kunder vendimit te gjykates se shkalles se pare, no baze te nenit 410 pika 2 te K.Pr.Penale, ka paraqitur ankim prokurori, i cili ka kerkuar ndryshimin e vendimit dhe duke gjykuar ceshtjen ne fakt, rrezimin e kerkesave te mbrojtetit te personit nen hetim, per keto shkaqe :

- Gjykata e ka pushuar ceshtjen me arsyetimin se vendimi per marrjen si te pandehur dhe njoftimi i akuzes, dergimi i ceshtjes per gjykim jane kryer jashte afatit hetimor tremujor, por ky konkluzion eshte i pavetete.
- Nuk rezulton ndonje mosrespektim i dispozitave mbi veprimet merine e akteve.
- Veprimet hetimore ndaj te pandehurit Polimer Bejo i kryer brenda afatit hetimor.
- Nuk eshte e vertete se regjistrimi i emrit te te pandehur Stefan Billa eshte bere ne te njejten kohe me ate te bashke te pandehur teter.
- Gjykata ka zbatuar gabim ligjin dhe praktikat gjyqesore te deritanishme kur e konsideron veprim hetimor jashte afatit hetimor per dergimin e ceshtjes ne gjykim dhe kerkesen per shpallje te hetimit.
- Keto akte, nuk mund te trajtohen si veprimet hetimore, te mretejshme hetimore, te cilat nuk mund te perdoren ne hetim te kryer pas mbarimit te afatit te hetimeve. Ato jane akte te perberura nga organi i prokurorise bazuar ne te gjitha veprimet hetimore kryera brenda afateve te hetimeve paraprake dhe bejne veprimet hetimore procedimit nga faza e hetimeve paraprake ne nje faze te re te gjykimit.

## GJYKATA E APELIT VLORE

pasi degjoi raportin e autorit relator Sokol Ngresi,  
pasi degjoi prokurorin ankimues Zeka, qe ne perfundim kerkoj prishjen e vendimit dhe kthimin e ceshtjes per gjykim;  
pasi degjoi mbrojtetesit te pandehurve Polimer Bejo dhe Stefan Billa, avokat Edmond Demaj, qe ne perfundim te gjykimit kerkoj lenien ne fuqi te vendimit te gjykates;  
pasi diskutoi ceshtjen ne teresi, perfundimisht,

## V E R E N

Vendimi i Gjykates se shkalles se pare Vlore nr.184 date 7.5.2013, me te cilin eshte vendosur pushimi i ceshtjes penale me numer rregjistri 865(156) date

26.12.2012 ne ngarkim te te pandehurve Polimer Beja dhe Stefan Billa te akuzuar per kryerjen e vepres penale "Fallsifikimi i dokumentave" me shume se nje here parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, eshte marre ne zbatim te drejte te dispozitave procedurale mbi ushtrimin e ndjekjes penale, mbi vlefshmerine e akteve te hetimeve paraprake si dhe rregullave qe normojne veprimtarine e organit procedues ne fazen e hetimeve paraprake.

Ka rezultuar nga provat e administruara gjate shqyrtimit gjyqesor se, Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare Vlore, ka urdheruar regjistrimin e proçedimit penal nr.1145 te vitit 2011 per vepren penale te falsifikimit te dokumentave dhe ne perfundim te hetimeve paraprake, ka paraqitur kerkesen per gjykimin e te pandehurve Polimer Beja dhe Stefan Billa, te akuzuar per kryerjen e vepres penale "Fallsifikimi i dokumentave" me shume se nje here parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

Para fillimit te shqyrtimit gjyqesor nga ana e te pandehurve, nepermjet mbrojtjesve te tyre ne baze te neneve 128, 131 dhe 325 te Kodit Penal eshte kerkuar te deklarohen te pavlefshme aktet e procedurave penale dhe konkretisht, njoftimi per vendimin per marrjen e Polimer Beja dhe Stefan Billa te pandehurit, pyetja e tij me cilesine e te pandehurit, njohja ne aktet e hetimeve paraprake, njoftimi i akuzes per te pandehurin Stefan Billa, pyetja e tij me cilesine e te pandehurit dhe pyetja e tij me cilesine e te pandehurit Stefan Billa, procesverbali i bashkimit te te pandehurit Stefan Billa, procesverbali per njohjen me aktet e hetimeve paraprake te Stefan Billa, vendimi per ndarjen e procedimeve date 12.12.2012, procesverbali i shpenzimeve procedurale, procesverbali i bashkimit te provave te shprehura, vendimi per dergimin e ceshtjes ne gjyq dhe kerkesea per gjykimin date 13.12.2012.

Te gjitha keto akte, si dhe akteve te pandehurve, duhet te deklarohen te pavlefshme per shkak se jane kryer ne afatet e afatit kryesor mujor te hetimeve pa marre vendim per zgjatjen e afatit te hetimit.

Pasi ka qene ne proces, Gjykata e shkalles se pare Vlore i ka gjetur te bazuara provat e mbrojtjesve te te pandehurve, duke vendosur keshtu pushimin e ceshtjes penale me numer rregjistri 865(156) date 26.12.2012 ne ngarkim te te pandehurve Polimer Beja dhe Stefan Billa te akuzuar per kryerjen e vepres penale "Fallsifikimi i dokumentave" me shume se nje here parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

Kunder vendimit te mesiperme te gjykates se shkalles se pare, ka paraqitur ankim prokurori, i cili ka kerkuar prishjen e vendimit dhe dergimin e ceshtjes per rigjykim.

Gjykata e Apelit Vlore, pas shqyrtimit te ceshtjes ne shkalle te dyte, konstaton se vendimi i gjykates se shkalles se pare, eshte i drejte, ne perputhje me urdherimet e dispozitave procedurale mbi ushtrimin e ndjekjes penale, mbi

vlefshmerine e akteve te hetimeve paraprake si dhe rregullave qe normojne veprimtarine e organit procedues ne fazen e hetimeve paraprake.

Keshtu, nga aktet ka rezultuar e provuar se

- Ne daten 12.9.2011, prokurori ka urdheruar regjistrimin e procedimit penal per veprat penale "Fallsifikimi i dokumentave" dhe "Shperdorimi i detyres" parashikuar nga nenet 186 dhe 248 te Kodit Penal.
- Pasi jane kryer hetime mbi egzistencen e fakteve penale dhe autoresine e ketyre veprave, ne daten 27.7.2012 eshte urdheruar rregjistrimi ne rregjistrin e veprave penale i emrit te shtetasve qe u atribuohen keto vepra penale. Ne pjesen urdheruese te ketij urdheri eshte urdheruar regjistrimi i emrave te shtetasve Polimer Beja i dyshuar per vepren penale "Fallsifikimi i dokumentave" me shume se nje here parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe Klodian Jahaj dhe Miriam Isufaj per vepren penale "Shperdorimi i detyres" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ne pjesen arsyetuese te urdherit prokurori eshte shprehur sikurse rezulton ne analize te te dhenave te deritanishme shtetas Polimer Beja dhe Stefan Billa dyshohen te jene konsumues te figures se vepres penale "Fallsifikimi i dokumentave" me shume se nje here parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal. Keto rrethana eshte e domosdoshme qe emri i shtetasve Polimer Beja, Stefan Billa, Klodian Brahaj dhe Miriam Isufaj te shprehjet ne njoftimin perkatese te rregjistrimit te njoftimit te veprave penale ne rregjistrin e veprave penale per te behet fjale per procedimin penal Nr 1145 te vitit 2011".
- Ne daten 23.10.2012, ndaj personit nen hetim Polimer Bejo, eshte marre vendimi "Per marrjen e personit si te pandehur dhe njoftimin e akuzes", vendim i cili eshte firmosur nga i pandehuri Polimer Beja ne cdo flete dhe eshte bere shenimi nga i pandehuri ne date 12.11.2012.
- Procesverbal "Mbi pyetjen e te pandehurit Polimer Beja" tre flete mban daten 10.11.2012 dhe eshte firmosur nga i pandehuri vetem ne fleten e fundit.
- Me date 10.11.2012 eshte mbajtur procesverbali per njohjen e te pandehurit me aktet ku datat duhet te jene plotesuar nga o.p.gj me shkrim dore.
- Me date 23 nentor 2012, ndaj personit nen hetim Stefan Billa, eshte marre vendimi "Per marrjen e personit si te pandehur dhe njoftimin e akuzes", vendim i cili eshte firmosur nga i pandehuri Stefan Billa dhe mbrojtesi dhe eshte bere shenimi nga avokati se mori njoftim ne date 10.12.2012.
- Procesverbali "Mbi pyetjen e te pandehurit Stefan Billa" nje flete mban daten 23.11.2012 dhe eshte firmosur nga i pandehuri.

- Ne date 27 nentor eshte urdheruar nga prokurori kerkimi i ketij te pandehuri me arsytimin se : *"Me vendimin e dates 23.11.2012 eshte marre si i pandehur shtetasi Stefan Billa per vepren penale te parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal. Me ftesen per paraqitje date 23.11.2012 shtetasi Stefan Billa eshte njoftuar per t'u paraqitur ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Vlore ne date 26.11.2012 ora 15.00 per tu pyetur me cilesine e te pandehurit dhe per tu njohur me aktet. Ndonese ka marre dijeni, shtetasi Stefan Billa nuk eshte paraqitur prane organit procedues".*
- Ne daten 10.12.2012 eshte mbajtur procesverbali per shqyrtimin e te pandehurit me aktet.

Problemi kryesor qe eshte shtruar per diskutim dhe analizim eshte vendimin e gjykates se shkalles se pare ka qene ai mbi vlefshmerine e akteve te tilla procedurale si vendimi per marrjen e personave ne gjykim, cilesine e te pandehurve, njoftimi atyre i ketij vendimi, marrja e personave me cilesine e te pandehurve, njohja me aktet, bashkimi i provave te shqyrtimit, vendimi per dergimin e ceshtjes ne gjyq dhe kerkesa per gjykim te afatit te afatet e hetimeve paraprake dhe pamundesine e organit procedues. Ky eshte kryesisht veprimet procedurale te gjykates se shkalles se pare.

Ndryshe nga sa pretendohet ne ankesat per prokurorin, ky arsytim i gjykates se shkalles se pare gjendet i drejte.

Vlefshmeria e akteve procedurale eshte moment shume i rëndësishem per shkak te garancive procedurale te cilat te sigurojne keto akte per subjektet pjesemarrrese ne procedim. Mosrespektimi i urdherimeve te dispozitave procedurale, pikerisht per mosrespektimin e kësaj rëndësie, passjell pasoja serioze per keto akte, vlefshmerine e tyre mund te ardhura nga mosrespektimi i tyre.

Ne lidhje me mosrespektimin e hetimeve paraprake, gjykata e apelit cmon fillimisht se mosrespektimi i rëndësies e respektimit te ketyre afateve dhe ne raport me kete rëndësi fillimin e ligjvënësimit per parashikimin e tyre ne ligj.

Afatet procedurale jane periudha kohore te caktuara ne ligj, brenda te cilave, subjektet e marrredhenies juridike procedurale penale kane detyrimin te kryejne detyrat e tyre apo te ushtrojne te drejtat qe ligji procedural ua njeh. Vendosija e tyre ne ligj ka si pikesynim kryesor disiplinimin e punes dhe veprimtarise procedurale te cdo subjekti, ne funksion te zgjidhjes se drejte te procedimit penal, zbulimit te se vertetes dhe venies perpara pergjegjesise penale te autoreve te veprave penale.

Pare ne kendveshtrimin e rolit qe ka organi procedues ne procesin e ndjekjes penale, keto afate kane si qellim edhe respektimin e te drejtave dhe lirive themelore te personave te cileve u atribuohet vepra penale, me qellim dhenies sa



me shpejt fund te gjendjes se ndermjetme juridike qe ata kane gjate procedimit penal ne funksion te dhenies se drejtesise. Ne kete kuptim, ne nenet 28 dhe 42 te Kushtetutes eshte percaktuar detyrimi i prokurorise per te perfunduar procedimin brenda nje afati te arsyeshem, qe nenkupton nje periudhe kohore te nevojshme qe duhet te harmonizojë, nga njera ane permbushjen e detyrimit qe ka shteti per te ndjekur dhe vene para pergjegjesisise penale autoret e veprave penale dhe nga ana tjeter respektimin e te drejtave te personave qe i nenshtrohen procedimit penal.

Per permbushjen e ketij qellimi, ligjvenesit ka parashikuar afate konkrete per perfundimin e hetimeve paraprake, respektimi i te cilave nuk duhet nenkuptuar si nje e drejte e organit procedues, por si kufij kohore detyrimisht te respektueshem nga ky subjekt. Per kete qellim ligjvenesit ka parashikuar castin e fillimit te ecjes se ketyre afateve, si dhe pasojat konkrete qe vijne si konsekuence e mosrespektimit te tyre.

Keshtu, sipas neneve 323 pika 1 dhe 324 pika 4 e K.Pr.Penale

*“Brenda tre muajve nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, prokurori vendos dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin ose pezullimin e saj, pasi në të kundërt, veprimet hetimore të kryera pas mbarimit të afatit nuk mund të përdoren.”.*

*Veprimet hetimore të kryera pas mbarimit të afatit nuk mund të përdoren.”.*

Moszbatimi i ketij detyrimi per te kryer veprimet hetimore ne fazen e hetimeve paraprake brenda ketyre afateve, dhe mosrespektimin faktik te ketyre afateve dhe per pasoje, demtimin rezultant te qellimit te ligjvenesit qe lidhet me respektimin e te drejtave te personave qe nenshtrohen procedimit penal dhe duke krijuar padrejtesisht favorizim te regjistruar procedues ne disiplinimin e punes se tij.

Ne funksion te kesaj referencine ne K.Pr.Penale jane percaktuar rregulla te qarta edhe per rastet kur organet procedues, per arsye objektive nuk mund t'i perfundoje hetimet paraprake brenda afateve percaktuar ne ligj. Ne nje shtate te tille, ligji i njej nga njera ane i detyron organet e prokurorit per te zgjatur afatin e hetimeve dhe nga ana tjeter respekton te drejtat e detyrimit e ketij organi per te vene ne dijeni mbi kete fakt te pandehurit (në objektin nen hetim) dhe njohur njekohesisht te drejten e tij per ta ankimuar dhe per te shprehur ne gjykate kete vendim te prokurorit.

Duke iu referuar rrethanave qe lidhen me kete procedim, rezulton se emri i te pandehurit Polimer Bejo si person qe i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale ne daten 27.7.2012 dhe brenda tre muajve duke filluar nga ky moment, prokurori duhej te kishte vendosur dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin ose pezullimin e saj, pasi ne të kundërt, veprimet hetimore të kryera pas mbarimit të afatit nuk mund të përdoren.

Me te drejte gjykata e shkalles se pare ka arsyetuar se ne te njejten date eshte regjistruar ne regjistrin e njoftimit të veprave penale emri i te pandehurit Stefan Billa si person qe i atribuohet vepra penale e falsifikimit te dokumentave. Ky

konkluzion del nga permbajtja e urdherit te prokurorit, te sipercituar, ku thuhet se :  
“Ne keto rrethana eshte e domosdoshme qe emri i shtetsave Polimer Beja, Stefan Billa, Klodian Brahaj dhe Miriam Isufaj te shenohet ne kolonen perkatese te rregjistrit te njoftimit te veprave penale ne rreshtin ku behet fjale per procedimin penal Nr 1145 te vitit 2011”.

Duke iu referuar rastit ne shqyrtim, konstatohet se organi procedues ka patur detyrimin e perfundimit te hetimeve per personat nen hetim Polimer Bejo dhe Stefan Billa, qysh ne daten 27.10.2012, nderkohe qe realisht kjo faze procedimi ka vazhduar per te deri me 13.12.2012, kur eshte marre edhe vendimi per dergimin e ceshtjes ne gjyq dhe eshte hartuar edhe kerkesa per gjykim.

Bazuar ne permbajtjen e nenit 331 te Kodit te Procedurës Penale, ligjvënësi ka vënë si parakusht që, para se të hartohet nga prokurori kërkesa për gjykim, duhet të jetë marrë prej tij vendimi për dërgimin e çështjes në gjykatë. Nëse për marrjen e këtij vendimi, bazuar në permbajtjen e pikës 2 të dispozitës së nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale, ligjvënësi ka vendosur si parakusht imperativ, që prokurori duhet të jetë siguruar më parë që i pandehuri dhe mbrojtësi i tij janë njohur me aktet e çështjes.

Nga mënyra e formulimit të kësaj dispozite del qartë nga aktet e çështjes nuk duhet kuptuar si një veprim thjesht formal nga ligjvënësi, duke përdorur shprehjen sipas së cilës, “... prokurori, para se të hartohet që i pandehuri ose mbrojtësi (i tij) është njohur me aktet (e çështjes), vendos ... dërgimin e çështjes në gjykatë”, kërkon siguri të plotë përsa i nënshtrimit të procesit të realizimit të njohjes së këtyre akteve nga personi që i nënshtrimit të kësaj penale dhe për të cilin kryhen, apo kundër të cilit drejtohen veprimet e prokurorit në fazën e hetimeve paraprake, përfshirë edhe ato veprime, të cilat meriten “Akte procedurale”, sikundër janë edhe vendimi për marrjen në gjykatë të pandehurit, vendimi për dërgimin e çështjes në gjykatë dhe kërkesa për gjykim.

Nëpërmjet kësaj dispozite duhet të procesit të njohjes së të pandehurit apo mbrojtësit me aktet e çështjes penale në ngarkim të tij, atij i jepet mundësia që, së pari, të paraqesë kërkesa eventuale rreth rregullshmërisë së procedurës së ndjekur gjatë kryerjes së veprimeve të ndryshme hetimore apo rezultateve të tyre dhe, ç’është akoma më rëndësishme, për të përgatitur një mbrojtje sa më efektive, të cilën do ta përdorë gjatë ecurisë së mëtejshme, deri në përfundimin në gjykatë të procesit penal në ngarkim të tij. Trajtimi në këtë mënyrë i rëndësisë së këtij procesi është në përputhje me frymën që del nga permbajtja e nenit 31/a, b të Kushtetutës së Shqipërisë, ku parashikohet se: Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë: a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet ...; b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet.

Nga ana tjetër, ky trajtim pajtohet edhe me frymën që i jep artikulli 6(3)(a) i KEDNJ të drejtës për t’u informuar mbi akuzën dhe që i përgjigjet pretendimit

legjitim të personit për të ditur pse shteti ka vepruar kundër tij, si dhe qëllimit për t'i dhënë atij informacionin që do t'i nevojitet për të përgatitur mbrojtjen.

Gjatë ushtrimit të funksionit të ndjekjes penale prokuroria zbaton dispozitat e neneve 277 deri 338 të Kodit të Procedurës Penale, të cilat, në tërësinë e tyre, kanë për objekt rregullimin ligjor të këtij procesi. Prandaj, pikërisht për shkak të rëndësisë që ka faza e ndjekjes penale, si njëra prej fazave të procesit penal në tërësi, mosrespektimin e dispozitave që lidhen me të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale, ligjvënësi, në përmbajtjen e shkronjës "b" të dispozitës së nenit 128 të Kodit të Procedurës Penale, e konsideron njërin prej tre rasteve të pavlefshmërisë absolute të akteve procedurale, që përcaktohen rigorozisht në këtë dispozite.

Sic u analizua edhe me lart, kryerja e veprimeve hetimore në afatin e hetimeve paraprake është atribut i drejtperdrejte i prokurorit dhe detyrimi i tij për ta kryer këtë veprimtari brenda një afati të caktuar fillimisht në ligj. Shkelja e këtyre detyrimeve, siç arsyetua më lart, duhet pas zgjatuar afatin e hetimeve, e pasuar nga veprime të tjera hetimore kryera të këtij afati të lejuar, si komunikimi i akuzës, njohja me aktet, vendimi për marrjen e çështjes për gjykim dhe kërkesa për gjykim, përben shkelje të drejtës së prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjen në procedim. Mosrespektimi i dispozitave procedurale që rregullojnë këtë funksion në paragrafin 128 pika 1 germa "c" të K.Pr.Penale i ben të gjitha aktet kryera pas perfundimit të afatit të hetimeve në datën 27.10.2012, absolutisht të pavlefshme, ku rëndësi paraqesin akti mbi njoftimin e akuzës, njohja me aktet dhe perfundimin e hetimeve si dhe kërkesa për gjykim.

Pretendimet e ngritura nga prokurori synojnë të provojnë se akti mbi njoftimin e akuzës, pvetërisht njohja me aktet dhe te pandehurit, njohja me aktet dhe perfundimin e hetimeve kryera brenda afatit tremujor, por me të drejte ky pretendim është gjatë procedurës gjyqësore nga gjykata e shkallës së parë.

Kështu, siç arsyetua nga prokurori se, në lidhje me te pandehurin Polimer Bejo, vendimi për marrjen e tij në cilesine e te pandehurit është marre në datën 23.10.2012 dhe njoftimi i akuzës është bere brenda dates 26.10.2012, pra brenda afatit tremujor të hetimeve. Nderkohe që, datat e evidentuara në vendimin për marrjen e tij si i pandehur, për njoftimin e këtij vendimi dhe pyetjen në cilesine e te pandehurit, tregojnë qarte se, se paku, njoftimi për marrjen e tij si i pandehur është bere pas dates 27.10.2012. Me të drejte gjykata e shkallës së parë arsyeton se nuk mund të jete njoftuar vendimi për marrjen në cilesine e te pandehurit në datën 23.10.2012, pyetja në kete cilesi në datën 26.10.2012 dhe njohja me aktet në datën 26.10.2012, nderkohe që njoftimi për vendimin me të cilin është marre i pandehur mban një date të mevonshme, datën 12.11.2012. është alogjike dhe absurde të mendohet se i pandehuri Polimer Bejo është njohur fillimisht me aktet dhe me pas,



rreth 17 dite me vone te jete njoftuar per marrjen si i pandehur. Kete perfundim, pra qe aktet e mesiperme i jane njoftuar te pandehurit Polimer Bejo pas dates 27.10.2012, e perforcon edhe shenimi i bere nga i pandehuri ne vendimin per marrjen si i pandehur qe mban daten 12.11.2012.

Po keshtu, eshte pretenduar nga prokurori se, ne lidhje me te pandehurin Stefan Billa, emri i tij ne regjistrin e njoftimit të veprave penale si person që i atribuohet vepra penale e falsifikimit te dokumentave eshte bere pas dhenies se deklarimeve ne daten 26.10.2012 nga i pandehuri Polimer Bejo. Nderkohe qe ky pretendim eshte i pavertete pasi, sic u evidentua edhe me lart, ne permbajtjen e urdherit te prokurorit date 27.7.2012 me te cilin eshte regjistruar ne regjistrin e njoftimit të veprave penale emri i te pandehurit Stefan Billa si person që i atribuohet vepra penale e falsifikimit te dokumentave, ku thuhet se "ne keto rrethana eshte e domosdoshme qe emri i shtetsave Polimer Bejo, Stefan Billa, Klodian Brahaj dhe Miriam Isufaj te shenohet ne kolonen perkat se regjistrin te njoftimit te veprave penale ne rreshtin ku behet fjale per procedimin Nr 1145 te vitit 2011".

Duke iu referuar datave qe mbajne vendimi per marrjen si i pandehur date 23.11.2012, njoftimi i vendimit per marrjen si i pandehur date 12.12.2012, keto dy akte procedurale shume te rendesishme rene ne shprehje te marre jashte afatit tremujor te hetimit.

Ndodhur perpara nje situate te tille, ate te kryerjes se veprimeve te rendesishme procedurale, si njoftimi i aktit kryesor dhe i te pandehurve me aktet, vendimi per ndarjen e procedimeve te hetimit per dergimin e ceshtjes ne gjykim dhe kerkesa ne gjykim, te cilat te parashikuar ne ligj per kryerjen e hetimeve paraprake dhe qe lidhen me te drejten e prokurorit per te ushtruar ndjekjen penale, me te drejte te shkalles se pare, ne zbatim te nenit 128 pika 1 germa "b" e K.Pr.Penal qe kerkon qe ato si absolutisht te pavlefshme.

Gjykata e shkalles se pare me te drejte i eshte referuar edhe jurisprudences se Gjykates se Apelit Nr.5 date 12.12.2008 ku trajtohet ne menyre te hollesishme rene ne shprehje procedurale te marra ne fazen e hetimeve paraprake, detyrimi i organit hetimor per te respektuar afatet e hetimit dhe pasojat e mosrespektimit te tij.

Ne mungese te aktit kryesor qe inicion procesin gjyqesor, ate te kerkeses per gjykim, per shkak te pavlefshmerise se tij absolute, me te drejte gjykata e shkalles se pare ka vendosur pushimin e ceshtjes penale ne ngarkim te ketyre dy te pandehurve.

Sa me siper, Gjykata e Apelit, per arsyt e sipercituara, duke i gjetur shkaqet e ngritura ne apelin e prokurorit te pabazuara ne ligj, ne perfundim te gjykimit çmon lenien ne fuqi te vendimit te ankimuar.

PER KETO ARSYE

Gjykata e Apelit Vlore, ne baze te nenit 428 pika 1 germa "a" e K.Pr.Penale,

VENDOSI

- Lenien ne fuqi te vendimit nr.184 date 7.5.2013 te Gjykates se shkalles se pare Vlore.

Vlore, ne 11.3.2015

ANETAR

ANETAR

KRYFSUL

VASIL HANXHARI

PETRIT ALIAJ

SOKOL CRESI

d.v.

d.v.



TE KRYESHEM  
ne Originalin  
KRYESHEM  
Sokol CRESI

Reporteri.al